




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: "Kujtesa Net" Sh.p.k.
Numri Unik Identifikues: 810547862
Pronar: Fiton Peja
Emri i OSHMA-së: K-SPORT 3
Adresa: Preoc, Km. 7 Magjistrallja, Prishtinë - Ferizaj.



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes K-SPORT 3, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. K-SPORT 3 është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 15 nëntor 2012, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA K-SPORT 3.
3. Me datën 15 nëntor 2022, ka skaduar afati i licencës për K-SPORT 3, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtëritjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 17 gusht 2022, K-SPORT 3 ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

Arsyetimi

5. OSHMA K-SPORT 3, ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe në pajtim të plotë me procedurat dhe kriteret e parapara.

6. Për shkak të mungesës së vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023, kërkesa e OSHMA K-SPORT 3 nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.

7. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

Vendim

8. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 23 qershor 2023, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së K-SPORT 3, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.

9. Licenca e KPM-së për OSHMA K-SPORT 3, do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 15 nëntor 2022.

10. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA K-SPORT 3, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.

11. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



23.06.2023

datë